

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Dëshirimi / *er-Ragbeh* / الرغبة

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَيَدْعُونَنَا رَغَبًا وَرَهَبًا"

"... dhe Na luteshin me dëshirim e ankth." (el-Enbijaa, 90)

Ragbeh apo dëshirimi (dëshira e fortë, e zjarrtë) është më afër të vërtetës sesa shpresa (*rexhaa*) dhe është mbi të. Kjo meqë shpresa është një aspiratë që i mungon verifikimi¹, ndërsa dëshirimi është kërkim pas verifikimit².

Dëshirimi ka tri nivele:

Niveli i parë është dëshirimi i njerëzve të informatave të transmetuara, të dala nga dija³. Ky dëshirim:

- Stimulon një përpjekje që nuk varet nga të parët (*shuhûd*)⁴

¹ Sepse ti shpreson shpërblimin e Allahut, por nuk ke garanci se e meriton.

² Ibn el-Kajjim tërheq vëmendjen se dëshirimi (*ragbeh*) mund të jetë edhe për diçka që s'ka garanci. Megjithatë, ai pajtohet se dëshirimi është një nivel më i lartë se shpresa (*rexhaa*), e cila është thjesht një aspiratë, ndërsa dëshirimi është një kërkim i etshëm që del nga kjo aspiratë, mu siç ikja (*harab*) del nga frika (*khauf*).

³ Dija e dobishme që bazohet në transmetime (Kurani, Suneti, dhe thëniet e sahabëve e të paraardhësve të tjerë të drejtë).

⁴ Kjo është të parët që ndodh në pozitën (*mekaam*) e *ihsanit*, ku personi adhuron Allahun sikur ta shihte. Mbi këtë nuk ka shkallë tjetër. Ibn el-Kajjim thekson se *fanaa* (vetasgjësimi), e cila nga sufite konsiderohet të jetë shkalla apo stacioni më i lartë, nuk është mbi këtë shkallë (*Ihsanin*). Konceptet e sakta të *fanaa*-së përfshihen në shkallën e *ihsanit*. Koncepti i gabuar i *fanaa*-së ul pozitën e ndjekësit e nuk e ngre. Një *muhsin* që adhuron Allahun sikur ta shihte, nuk do të shpërqendrohet nga krijesat (përfshirë dhe veten e tij) dhe nuk do t'i japë përparësi kënaqësisë së vet ndaj kënaqësisë së Tij. Ky, pra, është koncepti i saktë i *fanaa*-së apo vetasgjësimit / asgjësimit të egos.

- Mbron udhëtarin (e rrugëtimit shpirtëror) nga rraskapitja
- Parandalon pronarin e vet (dëshirimit) nga kthimi në bërjen e lëshimeve⁵

Niveli i dytë është dëshirimi i banuesve të një gjendjeje shpirtërore (*haal*)⁶, që është një dëshirimi i cili:

- Nuk lë potencial të pashfrytëzuar
- Nuk lejon venitjen e vendosmërisë
- Nuk lë ndonjë aspiratë tjetër veç të synuarës (*meksûd*)

Niveli i tretë është dëshirimi i njerëzve të të parit (*shuhûd*). Ky është një udhëtim i shoqëruar nga vigjilenca e skajshme, që asgjëson çdo shpërhapje⁷.

⁵ Bërjet e lëshimeve nuk janë të gjitha të njëjta. Allahu pëlqen që lëshimet të cilat Ai i bën për robërit të pranohen nga ata, për çka na vuri në dijeni edhe vetë i Dërguari ﷺ. Disa lëshime janë të obligueshme të bëhen, siç është ngrënia e një gjëje haram në rast domosdoshmërie; disa janë të rekomandueshme, siç është prishja e agjërimit në një udhëtim të vështirë; disa mund të jenë superiore, siç janë shumë nga lehtësimet e bëra në medhhebet (shkollat juridike) dhe në *ixhtihadet* e bëra për ata që kanë nevojë. Me kalimin e kohës, njerëzit mund të grihen në shkallën e *wera'* (ndërgjegjes së devotshme) duke pasur çdo herë e më pak nevojë për këtë lloj lëshimesh. Disa lëshime janë të ndaluara, siç është ndjekja e gabimeve të dijetarëve apo marrja e vendimeve më të lehta nga secili medhheb.

⁶ Në banuesin e këtyre gjendjeve, dëshirimi paraqet një shtysë të papërballueshme. Ibn el-Kajjim krahason këtë me shembullin e fluturave që tërhiqen nga drita.

⁷ Udhëtimi për të arritur pikën e *fanaa-së*, i shoqëruar nga ankthi se mund të shpërquendrosh nga arritja e saj. Rezultati përfundimtar është asgjësimi i plotë i shpërhapjes, pas çka mbetet vetëm një shqetësim (*hamm*) dhe vetëm një synim (*meksûd*). Në këtë shkallë, personi tashmë do të jetë larguar nga egoja aq shumë sa s'do të mund t'i shkaktojë ndonjë prapavajtje.